



**NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE  
(N.P.L.)  
PALLATI I RINISË SH.A.**

**PLANI PËR EVAKUIMIN DHE SHPËTIMIN NË  
SITUATA EMERGJENTE**

**Prishtinë, 15.12.2023**

Bazuar në nenin 20 të Ligjit nr. 04/L-111 Për ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 PËR NDËRMARRJET PUBLIKE dhe nenin 130 të Ligjit nr. 06/L-016 Për Shoqëritë Tregtare, bazuar në nenin 11, paragrafi 5 të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Kosovë nr. 04/L-161, bazuar në nenin 11, paragrafi 5 të Rregullores mbi sigurinë dhe shëndetin në punë dhe në bazë të nenit 8, paragrafi 8.3 të Statutit, Bordi i Drejtorëve të N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. në Prishtinë në mbledhjen e mbajtur me datën 15.12.2023, e miratojnë:

## **PLANIN PËR EVAKUIMIN DHE SHPËTIMIN NË SITUATA EMERGJENTE**

### **Neni 1.**

#### **Dispozitat e përgjithshme**

- 1.1. Qëllimi i programit mbrojtja e shëndetit dhe jetës së punëtorëve në rast rreziku nga zjarri,
- 1.2. Organizimi masat dhe menaxhimi i situatës së rrezikshme,
- 1.3. Evakuimi emergjent i punëtoreve,
- 1.4. Evakuimi i punëtorëve (personave) të lënduar-plagosur të cilët nuk mund të lëvizin pa ndihmen e tjerëve,
- 1.5. Mbrojtja e pasurisë dhe të mirave materiale të ndërmarrjes,
- 1.6. Organizimi dhe përballimi i situatave të rrezikut nga zjarri dhe fatkeqësitë elementare,
- 1.7. Rastet e rrezikut.

### **Neni 2.**

#### **Qëllimi i planit për evakuim emergjent**

- 2.1. Në rast rreziku të kaplimit të zjarrit në zyrat e N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. në Prishtinë, secili punëtor prezent në momentin e gjendjes së rrezikut pa panik, duhet të eliminoj shkaktoret (burimet) e zjarrit, ti s'kyç siguresat elektrike, makinat dhe të ndërmarr masat e mobilizimit të evakuimit të punëtorëve dhe personave të lënduar të cilët nuk mund të lëvizin pa ndihmën e tjerëve.
- 2.2. Punëtorët e rrezikuar, menjëherë duhet të fillojnë lëvizjet drejt daljeve dhe vendeve të sigurta.
- 2.3. Në afatin sa me të shkurtër kohor, duhet të organizohen për evakuim dhe të dalin duke i përcjell shenjat për dalje dhe për evakuim nga vendi i rrezikuar.

### **Neni 3.**

#### **Organizimi masat dhe menaxhimi i situatës së rrezikshme**

- 3.1. Të gjithë punëtorët, janë të obliguar që në rast rreziku pas evakuimit të organizohen dhe ndërmarrin të gjitha masat për shpëtimin e pasurisë, makinave dhe të mirave materiale.
- 3.2. Secili punëtor në momentin e situatës së krijuar të përcjell për orientim shenjat sinjalizuese (dalëse), të përballoj panikun dhe me qetësi dhe kontroll të vetëdijes të menaxhon

me situatën e re të krijuar, të filloj të dal nëpër rrugët sinjalizuese jashtë dhe në ndërkohë të s'kyç burimet e energjisë elektrike, makinat, etj.

3.3. Rojet ose secili person fillimisht të alarmon, jep shenjat e alarmit rreziku, varësisht nga shkalla dhe natyra e rrezikshmërisë të orientojnë punëtorët në vende të sigurta.

#### **Neni 4.**

#### **Evakuimi i punëtorëve (personave) të lënduar-plagosur të cilët nuk mund të lëvizin pa ndihmen e tjerëve.**

4.1. Pa humbur kohë, secili punëtor i ndodhur në situatën e rrezikut, duhet të kujdeset edhe për personat e lënduar të plagosur në afërsi, tu ndihmojnë që së bashku sa më parë të lëshojnë vendin e rrezikuar, duke ju përmbajtur shenjave sinjalizuese për dalje.

4.2. Dhënia e ndihmës së parë personave të lënduar dhe organizimi i dërgimit të tyre eventual në ambulancë dhe spital.

#### **Neni 5.**

#### **Mbrojtja e pasurisë dhe të mirave materiale të N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. në Prishtinë**

5.1. Secili punëtor i N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. në Prishtinë, menjëherë pas evakuimit të punëtorëve në vend të sigurt, duhet të organizohen dhe të ndërmarrin masat e duhura me qëllim të mbrojtjes së pasurisë dhe të mirave materiale, duke eliminuar fillimisht burimet e zjarrit dhe lokalizimin e tij deri në fikje.

#### **Neni 6.**

#### **Rastet e rrezikut**

6.1. Rastet e rrezikut mund të paraqiten, rrezikojnë punëtorët, pasurinë në çdo kohë, me intensitet kohë, zgjatje dhe pasoja në këto raste nga:

6.1.1. Zjarri

6.1.2. Eksplozimet

6.1.3. Tërmetet

6.1.4. Aktet terroriste

#### **Neni 7.**

#### **Kërkesat e sigurisë për rrugët evakuuese dhe dalje**

7.1. Rregullimi, mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i rrugëve evakuuese për dalje sa më të shpejtë nga ndërtesa e rrezikuar, duhet të mos çrregullohen dhe bllokohen në mënyrë që të mos vihet në rrezik siguria e punëtorëve dhe personalit tjetër.

7.2. Rrugët dhe daljet, duhet të jenë të lira dhe funksionale të sinjalizuara me shenjen "Dalje në rast rreziku", e vizatuar me shigjetë →.

7.3. Identifikimi i rrugëve dhe daljeve duhet të mos mbulohen me dekorime.

7.4. Rrugët dhe daljet emergjente, nuk duhet të ngushtohen, të bllokohen por duhet të jenë funksionale në çdo kohë.

7.5. Vendet me rrezik potencial zjarri dhe eksplozimi nuk mund të kufizohen me rrugët për dalje emergjente poashtu pranë rrugëve dhe daljeve emergjente, nuk duhet të deponohen materiet të cilat lehtë ndizen dhe eksplozojnë.

**Neni 8.**  
**Programi i trajnimit**

Obligimet e ndërmarrjes në lëmin e mbrojtjes kundër zjarrit, rregullohen më detalisht me Planin dhe Programin e trajnimit të punëtorëve të ndërmarrjes.

**Neni 9.**  
**Ndëshkimi**

Mosrespektimi i dispozitave të këtij plani, që kanë të bëjnë me te drejtën e zbatimit të këtij plani, paraqet shkelje te rende te detyrave te punës, që tërheq përgjegjësinë adekuate ligjore te parapare për këtë lloj shkeljesh, gjegjësisht shkelje te rende disiplinore.

**Neni 10.**  
**Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare**

**10.1.** Dispozitat e këtij Plani interpretohen dhe zbatohen në pajtim me Ligjin për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Kosovë nr. 04/L-161 dhe të Rregullores për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë të aprovuar nga N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. në Prishtinë.

**10.2.** Për interpretimin e ndonjë dispozite të këtij Plani, është kompetent Bordi i Drejtorëve i N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. në Prishtinë.

**10.3.** Me hyrjen në fuqi të këtij Plani, shfuqizohet Plani i mëparshëm për evakuimin dhe shpëtimin në situata emergjente.

**10.4.** Ky Plan aprovohet nga ana e Bordit të Drejtorëve të N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. në Prishtinë me datën 15.12.2023 dhe ndryshimet dhe plotësimet e këtij Plani, bëhen sipas të njëjtës procedurë, sikurse për nxjerrjen e tij.

**10.5.** Ky Plan hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga ana e Bordit të Drejtorëve të N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. në Prishtinë.

**APROVUAR:**

**Bordi i Drejtorëve:**

Ariana Pireva - Kryesuese

Gani Sopi – Anëtar

Vjosa Rrahmani – Anëtare

Shuajb Mehmeti – Anëtar

